# DËSHMI ARKIVI

**A-462905**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Bomba tjetër për qeverinë Rama/ Prova e fakte se ku shkojnë paratë e zhvatura nga korrupsioni |
| ADRESA | `https://lapsi.al/bomba-e-radhes-per-qeverine-rama-paralajmerohen-deshmi-dhe-dokumenta-per-parate-e-zhvatura-nga-aferat-e-korrupsionit-i1094291` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:53:55 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 10:24:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f889c714ee312dde9748d507cea0737fba49d0855e65eb19889e8e7e3c2a66a0` |
| TEKSTI | `74392eb5d68cc7528d3e485a3994115654fcaafb8e0e760b2b04abf9abee0560` |
| PAMJA | `af75d63372c3b324caae342dffde6935a8438c8bd8ba2705f89088ca44cf2531` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `868123c4c87e96d14c57a7fafaea14914bae00769478eed094ec579b4ffceb64` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/868123c4c87e96d14c57a7fafaea14914bae00769478eed094ec579b4ffceb64`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Bomba tjetër për qeverinë Rama/ Prova e fakte se ku shkojnë paratë e zhvatura nga korrupsioni

LAPSI.AL • 23 SEPTEMBER 2026



Bomba e radhës mbi skandalet e qeverisë së Ramës pritet të mbërrijë nga Austria, aty ku regjisori dhe producenti i dokumentarëve, fitues i disa çmimeve ndërkombëtare, Frederik Füssel, po punon për një dokumentar të ri investigativ, bazuar në dëshminë e një dëshmitari nga Shqipëria, identiteti i të cilit mbahet sekret.

Ndryshe nga publikimi i skandaleve të tjera të bazuara kryesisht në përgjime, dokumentari pritet të zbulojë jo vetëm skemat korruptive, por edhe se ku kanë shkuar paratë e aferave, deri llogaritë bankare të politikanëve të përfshirë.

Në një video të publikuar në rrjetet sociale nga gazetarja Lindita Çela duket gazetari austriak që mban në dorë një USB, për të cilën dëshmitari, identiteti i të cilit mbahet i fshehtë thotë se aty janë të ruajtura pagesat që janë bërë për njerëzit që ai akuzon.

Spekulimet janë se bëhet fjalë për projekte të njohura në Shqipëri dhe që kanë prodhuar afera të mëdha korrupsioni.

Dëshmia paralajmëron implikimin e zyrtarëve të lartë të mazhorancës në raste korrupsioni, të lidhura me përfitimin e fondeve publike për një sërë projektesh në Shqipëri.

Më poshtë video e shoqëruar nga mesazhi i gazetares Lindita Çela e cila shkruan se:

> **"Materiali që publikohet tani është vetëm një fragment i shkurtër i një investigimi më të gjerë, i cili do të sjellë në vijim detaje dhe prova që hedhin dritë mbi përfshirjen e gjithkujt, ndërsa hetimi dhe procesi i verifikimit vazhdon".**




ide



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi
Andi Bushati

MOTI TIRANA 22°C
KËMBIMI EURO 91.40

aktuale

08:28
Afro katër muaj në shesh, qytetarët nuk tërhiqen: Kërkojnë largimin e Ramës

21:41



Dita e 115-të e protestës/ Nuk mungojnë mesazhet e Vlora Hysenit




TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku





**Transkripti:**

**Gazetari:** Pra çfarë ka në këtë USB?

**Dëshmitari:** Të gjitha të dhënat, të gjitha pagesat...

**Gazetari:** Pra, nëpërmjet kësaj USB mund të shkosh tek të gjitha...? Dëshmitari: Të gjithë njerëzit që unë po akuzoj sot.

**Gazetari:** Pra këtu ke emrat?

**Dëshmitari:** Ke emra, shumën e parave, ke të dhëna, ke dhe arsyet se pse janë paguar këto para tek ata...

### Kush është gazetari Frederik Fussel

Frederik Füssel është regjisor, producent dhe drejtor fotografie austriak, me një karrierë që nisi në vitin 1992 në ABC TV Austria. Ai ka punuar në produksione filmike dhe televizive në më shumë se 50 vende dhe në vitin 2001 themeloi kompaninë FMproductions. Aktualisht është CEO dhe producent i Seven Ocean Pictures.

Füssel realizoi disa dokumentarë ndërkombëtarë. "Singing for Life" fitoi Çmimin Special në Prix Italia në Torino në vitin 2011. Një nga punët e tij të fundit është "People of ëar" (2024), dokumentar i xhiruar përgjatë dy viteve në Ukrainë, ku ndoqi vullnetarë që evakuonin civilë dhe shpërndanin ndihma pranë zonave të luftës.

Füssel ka punuar gjithashtu si drejtor fotografie në produksione televizive dhe realizoi projekte në Europë, Afrikë, Azi dhe Amerikën e Veriut./Lapsi.al

## Të këshilluara



**Zjarri në fshatin Akërni/ Digjet stani, situata problematike edhe pranë aeroportit të Vlorës**

Situata nga zjarri në zonën e Akërnisë vijon të jetë problematike. Flakët janë përhapur me shpejtësi në ...



**SPAK e ka marrë në pyetje Vlora Hysenin më parë, ja çfarë ka deklaruar shefja e SHISH**

Vlora Hyseni ka pasur komunikim të vazhdueshëm me Ergys Agasin edhe gjatë kohës që ai ka qenë person në kërkim. Sipas b...






**Video që tregon se Rama e dinte paraprakisht për Vlora Hysenin**



Arrestohet në Morinë shefja e SHISH, Vlora Hyseni



Ambasada amerikane mesazh për sigurinë, pasi u shpall në kërkim drejtuesja e SHISH



SPAK reagon zyrtarisht për "arrestin" e shefes së SHISH



## Arresti i Vlora Hysenit ndez debatet në Komisionin e Ligjeve



### Autoboti përplaset me urën në Elbasan, raportohet rrjedhje gazi dhe evakuohen banorët

Një incident i rrezikshëm është shënuar në "Urën e Lizës në Mengël të Elbasanit, pas mesnatës...



### Kreu i SHISH në arrest shtëpie/ Përplasje në Komisionin e Ligjeve, PD: Shteti ka rënë, cënohet siguria kombëtare

Masa e arrestit në shtëpi ndaj ish-kreut të SHISH, Vlora Hyseni solli sërish debate në Komisionin e Ligjeve. Oerd Bylykbashi: Rend dit...



### Zjarr në Llaman të Himarës, flakët favorizohen nga era. Forcat zjarrfikëse në vendngjarje

Një zjarr ka përfshirë kodrat mbi zonën e Llamanit, në Himarë.  Flakët janë shfaqur rreth orës 09:00 dhe, t&e...




## Demokratët Evropianë: Akuzat ndaj Hysenit të hetohen pa ndërhyrje, Shqipërisë i duhen institucione të forta!



### Detaje te reja për vdekjen e 36-vjeçarit që u hodh nga pallati, ne pranga babai i ish-bashkëjetueses së tij



Detaje të tjera mësohen në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur një ditë më parë, ku 36-vjeçari Geral...



### Zjarre në toka bujqësore dhe ullishte/ Në pranga dy persona në Fier, një tjetër procedohet në gjendje të lirë

Tre persona janë identifikuar nga Policia e Fierit si të dyshuar për zjarrvënie në disa zona të qarkut, ku dy prej tyre janë...



### Kompania e Agasit që do të thithte fondet e AKSHI-t, u themelua 48 orë para emërimit të Hysenit në krye të SHISH

Ka një koincidencë të dyshimtë dhe një datë që lidh Ergys Agasin me Vlora Hysenin, shefja e Shërbimit Informativ Shqipt...

## Me sytë katër



21:27

### PAMJET/ 6-vjeçarja kineze vë rekord botëror për zgjidhjen e Kubit të Rubikut

Një rekord botëror i pabesueshëm - dhe jo një herë, por dy herë - u thye brenda 3 ditësh nga 6-vjeçarja Lian Yunji ng...



PAMJET/ Nis papritur bora në bjeshkët e Deçanit

20:52



Dy VIDEO-t/ Si e paralajmëroi Gaz Bardhi lidhjen Gys Agasi-Vlora Hyseni

16:12



E RRALLE/ Trump del në TV pa zë për shkak të bojkotit të mediave

22:10



Berisha nxjerr VIDEON/ Pjerin Ndreu u përplas me shqiptarët e takimit të Ramës në Michigan

21:02

## SPORT

Të tjerë artikuj



12:43

### Kush është Younes Ebnoutalib, i thirrur nga Klopp me Gjermaninë me një përvojë te Perugia në Serie C: "Më trajtuan si një qen"



12:17

Serie A, parashikimet e Superkompjuterit: Interi kampion, Milan dhe Napoli jashtë Champions



11:51

E bujshme te Napoli: "Allegri drejt dorëheqjes!". Ja si qendron situata












Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.